

VENDIM
Nr. 96, datë 4.2.2015

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE TË DEKLARIMIT,
RUAJTJES, REGJISTRIMIT DHE PAAFTËSIMIT PËR ARMËT E KOLEKSIONIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7, të nenit 45, të ligjit nr. 74/2014, datë 10.7.2014, “Për armët”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në strukturën përgjegjëse të policisë, armët e koleksionit të kategorive “A”, “B”, “C” e “D”, që plotësojnë kriteret për t’u quajtur armë zjarri, regjistrohen njëjloj si armët e tjera, me të dhënat e numrit të serisë, tipit, kalibrit dhe fabrikën e prodhimit.

2. Armët e koleksionit ndahen në tri kategori dhe, që të quhen të tilla, duhet të plotësojnë njëren nga këto kushte:

- a) Të jenë armë të prodhuara, së paku, 50 vjet para datës së kërkesës për pajisje me autorizim;
- b) Të jenë armë të regjistruara nga Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore;
- c) Çdo armë tjetër që ka vlera të rralla, ose që lidhet me ndonjë figurë, periudhë apo ngjarje historike.

3. Personi fizik dhe juridik, për regjistrimin e armëve të koleksionit, ose muzeut, që nuk janë paaftësuar, pajiset me autorizim për koleksionim armësh nga komisioni qendror i ngritur në Drejtorinë Qendrore të Policisë së Shtetit, pasi ka plotësuar të gjitha kriteret e neneve 34 e 35, të ligjit nr. 74/2014, “Për armët”, si dhe kushtet e sigurisë së objektit, kriteret e sigurisë së armëve në vendin e koleksionimit, ose muzeut, sipas përcaktimit të akteve nënligjore.

4. Për armët e paaftësuar, personi fizik ose juridik paraqet dokumentin e lëshuar nga subjekti i licencuar për paaftësimin e armëve, të cilat janë vulosur me shkronjën “D”.

5. Personi fizik dhe juridik, bashkë me kërkesën dhe dokumentacionin që paraqet në komision, për të marrë autorizimin si koleksionist, ose person i autorizuar për administrimin e armëve në muze, sjell edhe listën me armët që zotëron.

6. Lista e armëve të jetë e ndarë në armë që janë të paaftësuar dhe armë që nuk janë paaftësuar. Për armët që nuk janë paaftësuar jepen të dhënat e armëve, ku përshkruhet tipi, kalibri, modeli dhe numri i serisë së armës.

7. Komisioni, para se të pajisë me autorizim për koleksionim armësh subjektin fizik a juridik, për armët e paraqitura, ushtron kontroll për saktësinë e të dhënave dhe, më pas, lëshon autorizimin për koleksionist armësh, ose si person i autorizuar për administrimin e armëve në muze.

8. Regjistrimi i armëve të koleksionit dhe atyre të muzeut bëhet nga sektori përkatës i policisë vendore, në regjistrin e armëve, sipas akteve nënligjore.

9. Tjetërsimi i pronësisë së armëve të koleksionit bëhet duke zbatuar kërkesat e ligjit për trashëgiminë kulturore dhe në përputhje me rregullat e ndryshimit të pronësisë së armëve.

10. Në rastet kur koleksionisti kërkon të blejë armë, më parë ai paraqet armën që kërkon të blejë, të dhënat për armën, subjektin ku do të blihet dhe arsyen e vlerat e armës. Blerja dhe shitja e armëve të koleksionit jashtë vendit bëhet me autorizim të policisë.

11. Lëvizja dhe transportimi i armëve të koleksionit bëhet me kërkesë të motivuar.

12. Titullari i policisë vendore autorizon transportin e armëve të koleksionit, me qëllim riparimi, provash në poligon ose ekspozimi.

13. Autorizimi i mësipërm nuk mund të lëshohet për më shumë se 6 (gjashtë) armë njëherësh.

14. Paaftësimi i armëve të koleksionit kryhet me të njëjtën procedurë dhe kriter si edhe për armët e tjera. Paaftësimi bëhet nga subjekte shtetërore të licencuara për riparimin e armëve.

15. Paaftësimi i përhershëm/çaktivizimi i armës së zjarrit bëhet sipas njëres prej procedurave teknike

të mëposhtme:

a) Foleja e fishekut të ketë tri vrima, të vendosura në kënd 120 gradë, me diametër të barabartë me kalibrin e tytës së armës së zjarrit, ose foleja e fishekut të jetë e mbyllur me sferë metalike dhe me saldim;

b) Tyta e armës së zjarrit të jetë e mbyllur (me metal të shkrirë) nëpër tërë gjatësinë e tytës;

c) Tyta e armës të jetë e prerë për së gjati, nëpër tërë gjatësinë e saj, me prerje të gjerë, së paku 5 (pesë) milimetra, e cila fillon nga foleja e fishekut;

ç) Për armët me mulli (revolver) paaftësimi i tytës bëhet njëloj si armët e shkronjës “a”, “b”, dhe “c”, ndërsa mulliri mbyllet me saldim.

16. Ngarkohet Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama